REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kapitullit III të Regullorës së QRK-së Nr.23/2013 për Percaktimin e Procedurave të Dhenies në Shfrytezim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit xx të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit, me dt.03.09.2015 , bie këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR MATJE TË OBJEKTEVE BANESORE AFARISTE DHE PËRPILIM TË KONTRATAVE ME BANORËT

I. Themelohet Komisioni Komunal për matje të objekteve banesore afariste të cilat janë të ngritura në pronën komunale që ipet në shfrytëzim afatgjatë, dhe përpilim të kontratave me banorët e atyre objekteve , në këtë përbërje:
1.Shkelzen Shehu, Kryetar i Komisionit, dhe me antar të Komisionit 2.Shkelzen Goçi, 3.Xheladin Malaj, 4.Hasan Hulaj, 5.Vlora Agaj, 6.Besim Sejfiaj, 7.Fatmir Kurmehaj, 8.Bilall Hadergjonaj, 9.Merita Binakaj.

II. Detyrë e Komisionit Komunal është që të bënë matjen e objekteve banesore dhe afariste në pronat komunale të cilat do të ipen në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite dhe pastaj të bënë përpilimin e kotratave me banorët e banesave qofshin ato për banim apo afarizëm, të cilat do të rrënohen sipas Vendimit të Kuvendit 01.Nr.VII-3 të dt.31.07.2015.

III. Për punën e tyre anëtarët e Komisionit do të paguhen nga 500 € çdo antar I Komisionit duke përfshi edhe Kryetarin e Komisionit.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

V. Me vendim njoftohen:
1.Të emruarit në pikën I. të Vendimit,dhe
2.Arhivi I KK Deçan.

01.Nr.VIII-2 ,
Dt.03.09.2015

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIKA E KOSOVËS • OPSTINA DECANE • KOMUNA E DEÇANIT • Skupstina Opstine • Kuvendi i Komunës

Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj